



Energy Regulatory Office
Zyra e Rregullatorit për Energji
Regulatorni Ured za Energiju

Më 25 tetor 2005 është nënshkruar në Athinë-Greqi Traktati që krijon Komunitetin e Energjisë në E.J.L. Shefi i ZRRE-së mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit së bashku me ZV/PSSP Dr. Joachim Ruecker dhe Zv/Ministrin e MEM Z. Agron Dida. Me anë të nënshkrimit të këtij Traktati, Kosova e përkushton veten që të pajtohet me Legjislacionin Evropian në sektorin e energjisë dhe t'promovojë konkurrencën e bazuar në parimet e tregut të lirë.

Fjala hyrëse nga Kryesuesi

Gjatë vitit tim të dytë si Kryesues, jam i lumtur t'ju kumtoj se ZRRE-ja ka kryer një tjetër performancë të shkëlqyer dhe është afruar edhe një hap drejt plotësimin të misionit të vet për t'u bërë faktori kryesor nxitës në Kosovë për krijimin e tregut efikas të energjisë që bazohet mbi parimet e transparencës dhe konkurrencës së lirë.

In në të gjithë pjesët e ZRRE-sa ka pasur arritje të rëndësishme gjatë çdo dite duke përmbushur shërbime të mira dhe është rritur vlera e konsumatorëve të energjisë për të përfaqësuar Kosovën në takime dhe konferenca të ndryshme ndërkombëtare.

Qartësia e objektivit tonë thelbësor-bërja e një tregu transparent dhe konkurrues të energjisë – do të thotë se ne kemi një qëllim të qartë dhe një fokus të fortë mbi atë që nevojitet të bëhet.



Nick Frydas, Kryesues i Bordit të ZRRE-së



Roli i ZRRE-së

Rregullimi luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, duke lehtësuar strukturën e përshtatshme institucionale dhe organizative që duhet të jetë e instaluar për të tërhequr investimet private masive, të cilat nevojiten për shfrytëzimin racional të burimeve natyrore.

Detyra kryesore e ZRRE-së është të krijojë kushtet për furnizimin e sigurt, të parrezikshëm dhe të shëndetshëm nga aspekti mjedisor me energji, të krijojë një treg konkurrues të energjisë në Kosovë, i cili do të bazohet mbi parimet e objektivizmit, transparencës dhe mos-diskriminimit.



Sipas Legjislacionit Parësor dhe Dytësor (Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë, Rregulli mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullit mbi Parimet e Përlogaritjes së Tarifave, etj.) ZRRE-ja ka autoritetin, detyrat dhe funksionet që të zhvillojë kushtet

për nxjerrjen e licencave për të kryer aktivitetet e energjisë, procedurave për dhënien e lejeve të ndërtimit për kapacitetet e reja gjeneruese, kriteret për rregullimin e çmimeve dhe kushtet për furnizimin me energji.



One of public sessions of the Board of ERO

Detyrat Kryesore të ZRRE-së për vitin 2006

- Monitorimi i Ristrukturimit dhe korporatizimit të ndërmarrjeve energjetike sipas Direktivave të BE-së.
- Zhvillimi i tregut të liberalizuar të energjisë në përputhje me kriteret e traktatit të Komunitetit Energjetik në Evropën Juglindore (ECSEE). Kjo do të stimulojë projektet e reja për investime private në sektorin energjetik në Kosovë.
- Licencimi i të gjithë aktiviteteve energjetike në Kosovë dhe zhvillimi i procedurave për monitorimin e përputhshmërisë së licencave

Legjislacioni Dytësor i zhvilluar dhe i aprovuar nga ZRRE-ja (miratuar nga Bordi)

15 dhjetor '05 deri 28 qershor '06

- Statuti I ZRRE-së
- Kodi I Etikës dhe Sjelljes
- Rregulli mbi Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë
- Metodologjia e Tarifave për Sektorin e Energjisë
- Rregulli mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë
- Pasqyra e Taksave
- Rregulli mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve
- Rregulli mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë
- Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji
- Rregulli mbi Regjistrin Publik

Draftet e botuar dhe komentet e diskutuara në Dëgjime Publike

- Rregulli mbi Masat Administrative dhe Gjobat
- Rregulli mbi Fshehtësinë e Informacioneve
- Rregulli mbi Autorizimin
- Doracaku I Veprimt

Rregullat e mësipërme janë planifikuar të miratohen në Gusht-Shtator 2006

Vendimet dhe Udhëzimet e Përkohshme të nxjerra nga ZRRE-ja

Vendimi D_12_2006,

Vendimi mbi tërheqjen e Pëlqimit të dhënë KEK-ut më 5 qershor 2006 mbi Eksportin e Energjisë Elektrike gjatë korrik-gushtit të vitit 2006

Vendimi D_11_2006,

Vendimi mbi "Aplikimin për Tarifa të Përkohshme" për ITSMO.

Vendimi D_10_2006,

Vendimi mbi "Udhëzimet ndaj Krijimit të Kufirit të Pronësisë dhe atij Komercial midis Kompanive Aksionare".

Vendimi D_09_2006,

Vendimi mbi Taksat për shqyrtimin dhe dhënien e Certifikatës së Privilegjitetit.

Udhëzimi i Përkohshëm I_03_2006,

Mbi parimet e Përlllogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë, për sezonin e ngrohjes 2006-2007.

Udhëzimi i Përkohshëm I_02_2006,

Mbi Raportimin ndaj Rregullatorit nga Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore.

Udhëzimi i Përkohshëm I_01_2006,

Për Kriteret e Matjes për Konsumatorët e Privilegjuar.

Raporti Vjetor i ZRRE-së për vitin 2005

Të gjithë Rregullat dhe Vendimet e ZRRE-së janë në dispozicion në: www.ero-ks.org





Pjesëmarrja e ZRRE-së në Konferencat, Mbledhjet, Punëtoritë, Seminaret Ndërkombëtare, etj.

- Vizitë pune në Shqipëri, 17-19 janar 2006.
- Mbledhja e SETSO TF në Zagreb-Kroaci, 20 janar 2006.
- Trajnim mbi Informimin e Rregullatorit dhe Pjesëmarrjen Publike në Budapest-Hungari, 22-25 janar 2006.
- Punëtori mbi Monitorimin e Rregullatorit në Sektorin e Energjisë Elektrike në Kazakistan, 1-2 shkurt 2006.
- Takimi i Grupit Punues të CEER SEEER në Takimin e Grupit të Rregullatorit të Gazit në Milano, 16 shkurt 2006.
- Mbledhja e Komitetit të ERRRA Licencim/Konkurrencë, Shkup, 23-24 shkurt 2006.
- Tre (3) Takime të SEC TF (Vjenë 9 mars, Budapest 16 maj, Athinë 21 qershor 2006.
- Grupi Punues I Përbashkët mbi Industrinë dhe Infrastrukturën e Gazit, Financimi dhe Rregullimi, Beograd

22-23 mars 2006.

Takimi i GP Ligjor të ERRRA-s, Budapest, 27-29 mars 2006.

• Mini-Forumi i Athinës dhe 15th Takimi i GP të EJL, Dubrovnik, 27-28 mars 2006.

• Punëtori "Adresimi i Sfidave Kryesore të Reformimit dhe Rregullimit të Ndërmarrjeve të Rrjetit, Londër, 27-31.03.2006.

• Vizitë studimore në Rumani, 10-15 prill 2006.

• Takimi i SEETSO-s në Budapest, 12 maj 2006.

• Konferenca vjetore e ERRRA për investimet në Ballkan, Budapest, 14-19 Maj 2006.

• Vizitë studimore nga SEETEC, Paris, Stokholm, 17-19 maj 2006.

• Pjesëmarrja në SETSO GD, Zagreb, 8 qershor 2006.

• Takimi I GP për Integrimin në BE I ERRRA "Garancitë e Origjinës" Budapest 9 qershor

• Nën-rajoni më i madh i Mekong, Takim i Sektorit të Energjisë, Rep. Siem Kamboxhia, 13-16 qershor 2006.

• Pjesëmarrja e Anëtarëve të Bordit të ZRRE-së në Forumin e Athinës, 19-24 qershor 2006.

Vizita studimore në Rumani, në ANRE.

